



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI
PËR ÇËSHTJET VENDORE

Shalsi Eduard
Minister



Eduard Shalsi

Z. Eduard Shalsi, ka lindur në qytetin e Korçës, në vitin 1968. Ai është i martuar me znj. Eranda Shalsi dhe ka 2 fëmijë, Patrikun dhe Samuelin.

Ka përfunduar studimet universitare në vitin 1990 në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në degën Biologji – Kimi në Tiranë dhe ka punuar fillimisht si arsimtar në shkolla të ndryshme të Tiranës.

Pas një largimi 3 vjeçar për në Greqi, kthehet dhe fillon punën në të parën bankë private në Shqipëri, Tirana Bank. Pas trainimeve të shumta brenda dhe jashtë Shqipërisë ai punon pranë degeve të ndryshme të bankës në Shqipëri në departamente të ndryshme si ai i depozitave, import-eksportit, kredisë, etj. Përpos certifikatave të shumta ai pajiset dhe me titullin ToT si Trajner në ekonominë bankare nga Bankakademie Ndërkombëtare Gjermani & ISAB Shqipëri gje që e ben te ngjitet në nivelet me te larta të menaxhimit te bankes.

Më pas emërohet si Drejtor i Përgjithshëm i kompanisë shtetërore shqiptare të sigurimeve Insig sha. dhe brenda një periudhe të shkurtër kohore pasi fillon një reformë të thellë strukturore për modernizimin dhe përmirësimin e të dhënave financiare, bën të mundur zgjerimin e aktivitetit të kompanisë në Maqedoni, si dhe tërheq si investitorë me 40 % respektivisht Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Bankën Botërore.

Në vitin 2004 i bashkëngjitet ekipit të Edi Ramës në Bashkinë e suksesshme të Tiranës, fillimisht si shef kabineti i Kryebashkiakut dhe më pas si nënkryetar i Bashkisë, periudhë gjatë të cilës udhëhoqi disa projekte me rëndësi për kryeqytetin.

Është zgjedhur deputet në qarkun e Tiranës në vitin 2009 dhe ka marrë pjesë aktive në jetën parlamentare.

Rizgjidhet deputet në zgjedhjet e 2013 por kësaj here në qarkun e Beratit. Ai ka shërbyer si Kryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, nënkryetar i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, anëtar në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, anëtar i Komisionit të Asocim-Stabilizimit BE-Shqipëri.

Zotëron gjuhën angleze, italiane dhe greke.

Gjithashtu z. Shalsi për shkak të pasionit dhe njohjes së mirë të shahut, është zgjedhur edhe President i Federatës Shqiptare të Shahut.